



Newsletter, KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1 SPECIALE

Index:

Aktivitetet 2

Aktivitetet 5

Aktivitetet 9

Aktivitetet 12

10 VJET KMD, SFIDË PËR DEKADËN E RE TË LUFTËS KUNDËR DISKRIMINIMIT DHE PROMOVIMIN E BARAZISË




Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi festoi 10 vjetorin e miratimit të ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimin dhe ngriten e institucionit, përmes një jave aktivitesh të shumëllojshme e gjithëpërfshirëse, jo vetëm në Tiranë.

Aktivitetet informuan dhe sensibilizuan komunitetet, organet publike dhe entitetet private, organizatat joqeveritare (OJQ), media, akademike, për të promovuar parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit, dhe të përfshijë të gjithë aktorët përkatës. Aktivitetet u përqendruna në komunitetet më të diskriminuara në Shqipëri pasi ato janë përfshirë në fushën e punës të KMD, gjatë këtyre viteve.

Për më tepër, disa aktivitete të rëndësishme u kryhen jo vetëm në Tiranë, por edhe në qytete të tjera të vendit, konkretisht në ato rajone ku KMD ka krijuar Zyrat e saj Rajonale, si Korça, Shkoder dhe Fieri. Duke e përfunduar me një takim solemn në kryesinë e Kuvendit.

AKTIVITETE

Ekspozita fotografike "Guxo të Jesh Vetvetja", kushtuar komunitetit LGBTI



Në kuadër të Javës Kundër Diskriminimit, sot u çel në ambientet e KMD ekspozita fotografike "Guxo të Jesh Vetvetja", kushtuar komunitetit LGBTI. Ekpozita qëndroi e hapur për të gjithë javën kundër Diskriminimit dhe u vizitua nga qindra persona të interesuar. Komisioneri Dr. Gajda u shpreh i lumtur që kremtimi i 10 vjetorit të KMD nis me ekspozitën kushtuar komunitetit LGBTI dhe në veçanti brenda ambienteve të institucionit.

“Promovimin e tolerancës midis feve”, takim në Elbasan për 10 vjetorin e KMD



Në javën Kundër Diskriminimit në qytetin e Elbasanit u zhvillua një takim mbi “Promovimin e tolerancës midis feve”, në bashkëpunim me Qendrën e Bashkëpunimit Ndërfetar. Në këtë takim folën Komisioneri Dr. Gajda; Kryetari i Bashkisë Elbasan Z.Gledjan Llatja; Kryetari i Qendrës për Bashkëpunim Ndërfetar Z.Arben Ramkaj; Përfaqësues i Prezencës së OSBE në Shqipëri Z. Robert Wilton; Kryetari i Keshillit të Qarkut Elbasan z. Bukurosh Stafa. Teksa përshëndeti komisioneri Dr.Gajda u shpreh për ngritjen e një Instituti per studime fetare mes institucionit të KND dhe Qendrës së Bashkëpunimit Ndërfetar.



“Promovimi i tolerancës midis feve”



Fjala e Komisionerit Dr. Gajda:

-“Ligji për mbrojtjen nga Dsikiminimi i kushton një dispozitë të vecantë pikërisht besimit fetar dhe qëllimi ka qënë specifik, vlerat mbrohen në përditshmërinë e tyre, mbrohen duke bërë parashikime ligjore, por mbrohen pastaj duke i pretenduar shkeljet apo tentativave që mund të ketë nga shoqëritë apo organet publike për ta dëmtuar, apo prishur, që do të thotë në lidhje me zyrë e komisionerit në të vërtetë në 10 vite punë nuk kemi pasur ekspozim të qëndrueshëm të diskriminimit me bazë fetare, kjo nuk do të thotë se nuk ka, por nga ana institucionale, sjellja në formë ankesash, jemi të rrahur në ekspozimin e këtij lloji diskriminimi. Po që mendoj që mënyra më e mirë është që duhet të kemi më shumë jo vetëm ankesa por edhe sinjalizime të ndryshme që mund të vijnë nga qytetarë. Kam kënaqësinë të ju informoj që në bashkëpunim edhe me Qendrën për Bashkëpunim Ndërfetarë shumë shpejt do të jemi pjesë e një instituti për të kryer studime fetare në Shqipëri sepse ndjej që ka munguar në vazhdimësi apo një konsistencë e studimeve të cilat pastaj shërbejnë shumë mirë për tu ndërmarr jo vetëm politika të mëdha nga organet politike por edhe për tu dhënë dhe për të kontribuar konkretisht në përmirësim të legjislacionit, implementimin e tij, në zgjidhjen institucionale të situatave në fokusim më të mirë të nevojave reale që mund të paraqesin anëtarët e

komunitetit. Është një bashkëpunim shumë Intesiv dhe shpresojmë që të kemi një konferencë në lidhje me këtë gjë dhe të fillojmë sa më shpejt nga puna për kryerjen e studimeve me bazë fetare, për të patur studime sa më të qëndrueshme dhe konkrete në evidentimin e nevojave që shoqëria ka.

Gjëja e dytë që doja të thoja është vecantia që ka qyteti Elbasanit për shkak se ka Qendrën për Bashkëpunim Ndërfetarë, është e vecantë sepse simbolizojmë harmoninë fetare, është më e prekshme nga qytetarët kur zbret në nivel lokal, përforcohen më mirë situatat e ndryshme në nivel lokal. Uroj dhe shpresoj që modeli Elbasanit dhe i Qendrës për Bashkëpunim Ndërfetar të përcohej edhe në qytetet e tjera sepse kam bindjen që është më e prekshme nga qytetarët dhe mund të japim një kontribut më konkret më efektiv në lidhje me përditshmërinë e qytetarëve në lidhje në të gjitha dimensionet për shkak të besimit të tyre fetar. Toleranca shqiptare në Shqipëri duhet marr si një model dhe duhet konkretizuar si një formë modeli të mirë, të harmonisë dhe mirekuptimit dhe të përcohet në të gjitha grupet shoqërore dhe të ketë harmoni dhe tolerance jo vetëm në grupet fetare por më e rëndësishmja të ketë harmoni dhe tolerancë në të gjitha grupet shoqërore sepse kjo është baza në të gjitha institucionet publike, ku të gjithë të shprehin përkatësinë dhe ekzistencën e tyre. Të gjithë grupet shoqërore të kenë mundësi të pranojnë njëra tjetër pa i paragjykuar ato dhe të garantojnë vlerën esenciale që cdo shoqëri duhet të ketë.

Jemi të gjithë qenie njerëzore dhe duhet ta pranojmë njëri-tjetri si qenie njerëzore. E rëndësishme është dhe ndërtimi urave të komunikimit me autoritetet qëndrore dhe vendore.”



Shfaqja teatrale "SFIDA", tejkaloi pritshmëritë artistike dhe njerëzore



Në ditën e dytë të "Javës Kundër Diskriminimit" u mbajt në Teatrin "Art Turbina" shfaqja Teatrale "Sfida", luajtur nga persona me aftësi të kufizuara. Mirëpritja e publikut ishte e jashtëzakonshme jo vetëm që salla u tejmbush, por edhe duartrokitjet ishin të ngrohta!

"Sfida" ishte një shfaqje e integruar me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara, por edhe të bashkëmoshatarëve të tyre pa aftësi të kufizuara, student të akademisë së arteve por dhe vullnetar të thjeshtë. Shfaqja përfshiu 30 persona nga 9 aktor të ndryshëm kryesisht shoqata që janë të angazhuara në fushën e aftësisë së kufizuar. Në skenë u angazhuan persona me autizëm profesionist të artit si regjisorja Mirketa Cobani persona me probleme në shikim dhe të gjitha kategoritë e aftësisë së kufizuar.

Shfaqja e një tipi vodvil (teatër, këngë kërcim por jo mjuzikal) të krijonte një admirim dhe në të njëjtën kohë dhe të argëtonte. Është fakt që aktori gjendet në një konflikt të vazhdueshëm me jetën reale, por në atë shfaqje shumë nga pjesëmarrësit luanin veten e tyre. Mesazhe të

forta dhe pjesë aktive e shfaqjes dhe persona me aftësi të kufizuara intelektuale.



10 vjet KMD, promovimi i komunitetit Rom dhe Egjiptian në Korçë



Në ditën e tretë të Javës Kundër Diskriminimit u mbajt në Korçë aktiviteti me fokus pakicat rome dhe egjiptiane, ku u shpalosën rastet kryesore të diskriminimit të ndjekura nga KMD në lidhje me strehimin dhe fusha të tjera, si dhe shembuj praktikë të zbatimit të tyre dhe arritjes së efektivitetit.

Morën pjesë në panel: Z.Sotiraq Filo, Kryetari i Bashkisë Korçë; z.Robert Gajda Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Bledar Taho, Drejtor IRCA dhe Pika Fokale e Programit ROMACTED për Shqipërinë; z. Gentian Serani, aktivist i njohur i komunitetit; znj. Entela Lako, Përfaqësuese e UNDP.

Fjala e Dr. Gajda

Në 10 vjet zyra ka filluar të jap frutet e saj. Këtë e tregon numri në rritje i ankesave nga vitit në vit. Konkretisht ankesat që vijnë nga komuniteti rom dhe egjiptian përbëjnë numrin më të madh të tyre. Në rastet eshqyrtuara diskriminimi i shfaqur ka qenë i shumfishtë, pra i lidhur me

një sërë problematikash, si arsimi dhe gjendja ekonomike. Format e diskriminimit si segregimi, gjuha e urrejtjes, mungesa e shërbimeve ose mosfrimi i shërbimeve në zonat e banuara nga komuniteti rom dhe egjiptian, sic janë mungesa e energjisë elektrike, strehimi, uji etj. Janë detyrim për çdo organ publik shtetëror për tu përmbushur.

Është rritur ndjeshmëria e institucioneve nga shoqëria edhe pse me hapa të vegjël.

Komisioneri nuk ka për qëllim që të jetë kritik në vetvete ndaj institucioneve, por të nxit bashkëpunimin për parandalimin e rasteve të diskriminimit dhe zgjidhjen e problematikave pa qenë nevoja që të marrë masa penalizuese. Vendimet dhe rekomandimet e KMD kanë patur për qëllim që zgjidhjen e situatës diskriminuese.

Bashkëpunimi me pushtetin lokal dhe bashkinë e Korçës ka qenë për t'u përshëndetur, në vecanti rezultatet për komunitetin rom dhe egjiptian. Zyra e Korçës një asset për qytetarët korçarë.



"Gjuha e Urrejtjes" – Aleanca kundër Urrejtjes, takim në Universitetin Ismail Qemali, Vlorë.



Në ditën e katërt të Javës Kundër Diskriminimit u mbajt në universitetin e Vlorës takimi me temë "Gjuha e Urrejtjes" – Aleanca kundër Urrejtjes. Në panelin hapës morën fjalën zv.Rektori i UV Z. Kristofor Lapa; Avokatja e Popullit Znj.Erinda Ballanca; Përfaqësues i AMA; Kreu i Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, Znj. Jutta.

Dr. Gajda në fjalën e tij theksoi rëndësinë që merr kjo temë në ditët e sotme kur gjuha e urrejtjes është shumë prezente kudo. Ndaj ku më mirë se me studentët dhe nxënësit mund të flasim dhe të diskutojmë për këtë problematike të mprehtë, e cila nga gjuhë urrejte sot nesër mund të marrë përmasat e një krimi. Jemi shumë të lumtur që gjykatat kanë filluar të ndeërgjegjësohen në lidhje me këtë problematikeë, duke dhënë kështu rezultatet e para pozitive për këtë gjë. Kjo tregon se ka filluar një praktike e mirë për ti prerë rrugën kësaj gjuhe. Duhet të promovojmë tolerancën

dhe frymën e bashkepunimit. Aleanca kundër gjuhës së urrejtjes me 4 institucione: KMD, AP, Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Këshilli i Medias e ka këtë mision dhe ne do të punojmë për të luftuar diskriminimin dhe urrejtjen.

Kreu i Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, Znj. **Jutta**: Mbështetja që KiE i ka dhënë KMD dhe Aavokatit të Popullit me disa projekte ka hedhur disa hapa përpara. KiE përmes projekteve me disa aktorë nxit dhe promovon diversitetin, lirinë e shprehjes, medias dhe dënon gjuhën e urrejtjes, racizmit e antisemitizmit. Po ashtu inkurajon dhe vë theksin në zbatimin e parashikimeve të Konventës për Mbrojtjen e Drejtave të Njeriut



KMD, takim për të drejtat e gruas, fëmijëve të ngjuar me Ojf, personalitete dhe aktivistë.




Në ditën e Pestë të Javës Kundër Diskriminimit u mbajt në Shkodër një takim i zgjeruar për të drejtat e gruas, fëmijëve të ngjuar me Ojf, personalitete dhe aktivistë.

Në fjalën e tij, Komisioneri Dr. Gajda tha se, ky takim përmbyllës në Shkodër me fokus grua ja jo veteëm informim, por edhe bashkëbisedin e diskutim së bashku për çështje të barazisë në tërësi dhe të drejtat e grave e barazisë gjinore në veçanti, ende e pa arritur tek ne.

Ankesat me bazë gjinore shumë të pakta. Kjo lidhet me perceptimin dhe kulturën, ndaj kërkohet bashkëpunim.

Dhuna është rritur si në familje dhe shoqëri, por nuk ekspozohet me ankesa në KMD, gjë që nuk na jep mundësi të hyjmë thellë për zgjidhjen e problemeve.

Ngacmimi seksual po ashtu një problem, por që nuk raportohet. Të gjitha këto lidhen me disa faktoreë, por neë veçanti me pozitën e dobët të gruas në shoqëri.



Ekspozitë e rinore për perceptimin e të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimit, Korçë



Vajza dhe djem nga zona të ndryshme të Shqipërisë, përcollën përmes artit të tyre mendime dhe ndjenja të lidhura me shumëllojshmërinë (diversitetin), si një vlerë që duhet çmuar dhe mbrojtur në shoqërinë tonë. Ekspozita u hap në teatrin “Andon Zako Çajupi” Korçë, për të përkujtuar 10-vjetorin e Ligjit kundër Diskriminimit dhe ngritjen e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Veprimtaria u çel nga Komisioneri, Robert Gajda, Specialistja e Drejtësisë për të Mitur pranë UNICEF Albania Emira Shkurti, artisti që u përkujdes për punimet artistike, Sead Kazanxhiu, dhe u ndoq nga përfaqësues të institucioneve arsimore, Bashkia Korçë shoqëria civile, fëmijë dhe të rinj. Barazia, mosdiskriminimi, toleranca dhe shumëllojshmëria/diversiteti janë vlera të rëndësishme në edukimin e të rinjve, me ndjenjën e drejtësisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është një institucion i rëndësishëm, i hapur edhe për fëmijët për t'i mbrojtur ata nga diskriminimi dhe përjashtimi.



Takim përmbyllës në Kuvendin e Shqipërisë për 10 vjetorin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi



Në kryesinë e Kuvendit të Shqipërisë u mbajt takimi përmbyllës i "Javës Kundër Diskriminimit", në kuadër të festimit të 10 vjetorit të Ligjit dhe Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me moton për "PërNjëShoqëriPaDiskrimim". 10 vjet nga hyrja në fuqi e ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" që shënoi një hap të rëndësishëm në garantimin e aplikimit të principit të barazisë në Shqipëri, deputetë të parlamentit, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile u mbledhën në Kuvendin e Shqipërisë për të folur mbi arritjet e ligjit në luftën kundër diskriminimit në sektorin publik e privat.

Aktiviteti mbylli "Java kundër Diskriminimit" në bashkëpunim me Këshillin e Evropës në Tiranë, duke përfshirë një seri aktivitesh publike në mbarë vendin për të promovuar principet e barazisë, mos-diskriminimit dhe qeverisjes së mirë.

Dekada e dytë e KMD do të jetë plot sfida dhe beteja publike për të promovuar barazinë dhe mos diskriminimin në shoqërinë tonë.





"Mbi pavarësinë e organeve të pavarura dhe efektivitetin e tyre"

Dr. Robert Gajda

Tashmë Shqipëria është në një moment kyç pasi aspiron fort dhe është pranë afrimit politik dhe juridik me BE, i cili pashmangshmërisht sjell edhe rrjedhoja ekonomike dhe sociale.

Në kuadër të këtij përafrimi dhe synimi integruar u miratua para 10 vjetësh edhe Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi si pjesë e hapave konkretë që Shqipëria duhej të ndërmernte në mbrojtje të drejtave të njeriut, e akoma më tepër të një parimi bazik të bashkekzistencës shoqërore, atij të Barazisë. Ngritja e një institucioni të posaçëm ligjor, i cili tashmë, me modifikimet kushtetuese të 2016, gëzon edhe dinjitet kushtetues, përforcoi më shumë vullnetin e garantimit të barazisë duke siguruar mbrojtje efektive të qytetarëve nga sjelljet diskriminuese të gjeneruara nga organet publike por edhe nga subjektet private. Njohja në ligj e Pavarësisë së këtij institucioni përbën thelbin e garancisë për shprehjen e njëtrajshme të funksionit dhe ka për qëllim krijimin e të gjitha kushteve për ushtrimin efektiv të kompetencave për promovimin e barazisë dhe ndreqjen e sjelljeve diskriminuese.

Arkitektura e ndërtimit të ligjit dhe institucionit përkon me 4 direktivat bazë të BE kundër diskriminimit, por edhe te Rekomandimit të Përgjithshëm Nr.2 (i rishikuar) të Komisionit European kundër Racizmit dhe Intolerancës, si dhe së fundmi (Qershor 2018) të Rekomandimit të Komisionit European mbi standardet e Organeve të Barazisë.

Në këto dokumente e shumë raporte të tjera periodikë të organizmave të ndryshëm ndërkombëtarë të cilët monitorojnë Shqipërinë, vihet gjithmonë theksi pikërisht në këto dy aspekte: pavarësia dhe efektiviteti. Aspekte të cilat po ti shikojmë në një plan më të gjerë i referohen të gjitha autoriteteve të pavarura në një rend kushtetues, pasi vetëm në këtë mënyrë ekzistenca e këtyre organeve do të merrte kuptim dhe ndikimi i tyre do të sillte ndryshim. Organet e pavarura në tërësi dhe ato në mbrojtje të drejtave në veçanti, janë indikator që

tregojnë arritjen institucionale të Shtetit dhe aftësisë së tij për të kuptuar gabimet dhe për ti ndrequr ato. Detyra kryesore e organeve të pavarura është që të krijojnë hapësirat e duhura për pjesëmarrje demokratike, humanizëm, profesionalizëm dhe besim nga publiku. Pjesëmarrja demokratike, lidhet me faktin se në pjesën më të madhe këto organe zgjidhen nga Parlamenti por kërkohet një rol më ndikues i shoqërisë civile, e cila në mënyrë të strukturuar duhet të ketë zërin e saj në procesin përzgjedhës.

Humanizmi i organeve të pavarura e sidomos i organeve në mbrojtje të drejtave të njeriut, duhet të jetë shembulli dhe modeli më i qartë se si autoriteti publik duhet të trajtojë qytetarët dhe të dëshmojë rolin e tij në shërbim të të gjithëve, sidomos të grupeve më të pamundura shoqërore.

Profesionalizmi i ushtrimit të kompetencave garanton objektivitetin e shprehjes së funksioneve të tyre, i cili është një kusht i domosdoshëm për të pretenduar besimin e individëve dhe grupeve shoqërore. Prandaj, në këtë këndvështrim, garantimi i pavarësisë së organeve të pavarura është detyrë e përditshme dhe e përhershme e Kuvendit, i cili me peshën e tij në strukturën kushtetuese është aleati kryesor pacenueshmërisë së këtyre organeve. Nga ana tjetër, raporti i organeve të pavarura me të gjitha autoritetet e tjera publike vendoset në një kuadër komunikimi korrekt institucional, kuptimi i rolit të organeve të pavarura, si dhe bashkëpunimi midis të gjitha organeve për garantimin thelbësor të të drejtave dhe ofrimin dinjitoz të shërbimeve publike. Në fund të fundit, në thelb, pretendimi kryesor i qytetarëve kundrejt Shtetit dhe vetë kuptimi ekzistencial i këtij të fundit është që të garantohen të gjitha të drejtat Kushtetuese, Ndërkombëtare dhe Ligjore. Prandaj, gjithmonë Shoqëria është qëllimi dhe Shteti është instrumenti që shoqëria përdor për të realizuar pretendimet e saj. Unë shpreh bindjen, se tashmë jemi në momentin që të kemi një ri konsiderim të kuptimit që organet publike qendrore dhe vendore duhet të kenë kundrejt organeve të pavarura e sidomos të atyre që janë ngritur posaçërisht për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Këto organe nuk janë aty thjeshtë për të kritikuar për hir të kritikës, apo për të ndëshkuar për hir të kapriçeve të një titullari, por për të hetuar dhe ekspozuar mos funksione, parregullsi, paligjshmëri e për rrjedhojë, cenim të të drejtave.



"Nga ana tjetër, jo vetëm ekspozim por edhe ofrim bashkëpunimi për zgjidhje të situatave sipas standardeve dhe kuptimit më të mirë të parimeve kushtetuese dhe atyre ndërkombëtare.

Në funksion të kësaj, rekomandimet, vendimet, opinionet ligjore, raportet, studimet, monitorimet, anketimet e shumë instrumenta të tjerë të ndryshëm, i shërbejnë më së pari vetë organeve publike, në mënyrë që të kuptojnë problematikat e tyre me qëllim ndreqjen. Moszbatimi dhe mos ndjekja e të gjitha ekspozimeve dhe rekomandimeve që organet e pavarura në mbrojtje të drejtave të njeriut bëjnë, jo vetëm që zbeh dhe dobëson rolin e tyre derisa i vendos në disa raste edhe në dyshime ekzistenciale, por njëkohësisht bën që pandjeshmëria e organeve publike qendrore dhe vendore të thellojë cenimin e të drejtave dhe mos garantimin e ofrimeve të shërbimeve, të cilat në më të shumtën e rasteve rëndojnë shumë herë më shumë në grupet shoqërore më të pamundura. Prandaj ritheksoj, se qasja e organeve publike në tërësi kundrejt organeve të pavarura duhet të jetë komunikuese, kuptuese dhe bashkëpunuese.

Për ta përmbyllur, me një mesazh pozitiv dhe shpresëdhënës, i cili pa diskutim ndikon në afrimin e Shqipërisë me BE:

Së pari, një hap pozitiv është hedhur nga vetë Kuvendi i Shqipërisë. Mekanizmi i Përbashkët i Monitorimit të zbatimit të vendimeve dhe rekomandimeve të organeve të pavarura, është një mjet që po jep produktet e tij dhe po shkon drejt një përmirësimi dhe efektiviteti të dukshëm.

Së dyti, Pushteti Gjyqësor ka filluar të hyjë thelbësisht në çështjet që trajtojnë cenimin e parimit të barazisë dhe mos diskriminimit. Janë bërë me qindra tashmë çështjet

që trajtohen nga gjyqësori si duke trajtuar ankimet kundrejt vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ashtu edhe duke marrë në shqyrtim paditë direkte që i drejtohen nga qytetarët. Këto të fundit kanë qenë progresivisht në rritje vit pas viti. Ky është një lajm i mirë sepse tashmë qytetarët kanë dhe një aleat tjetër kundër sjelljeve diskriminuese. Aktualisht kanë filluar të formësohen precedentë dhe disa dhjetëra rekurse presin Gjykatën e Lartë që të shprehet.

Së treti, vihet re formësimi i një koshence institucionale pasi janë rritur rastet kur organet publike nuk i ankimojnë më në mënyrë rutinë apo thjeshtë për ti mbajtur pezull zbatueshmërinë e vendimeve të KMD, por në një farë mënyrë pranojnë dhe kuptojnë që ka një problem. Kjo vihet re si nga organe të pushtetit qendror ashtu edhe nga organe të pushtetit vendor. Gjithashtu vihet re një rritje e zgjidhjes së rasteve nga vetë organet publike akoma pa përfunduar shqyrtimi nga KMD.

Së fundmi, me ngritjen e Gjykatës Kushtetuese, qytetarët do të kenë edhe një instrument shtesë në mbrojtje të të drejtave të tyre, pasi komisionerët në mbrojtje të të drejtave të njeriut ashtu siç edhe Avokati i Popullit, mund të ngrenë tashmë çështje të natyrës kushtetuese. Ajo që synohet në të vërtetë, nuk është thjeshtë ekspozimi i disa rasteve sporadike pozitive, por që tashmë kuptueshmëria dhe zbatueshmëria e vendimeve dhe rekomandimeve të kthehet në frymë dhe të vendoset si standard i pranuar nga të gjithë subjektet që ushtrojnë funksione publike.

Jam thellësisht i bindur që nëse organet publike në tërësi do të priren nga komunikimi, kuptimi i ndërsjelltë dhe bashkëpunimi, të drejtat e qytetarëve do të jenë më të garantuara dhe afrimi i integritetit të plotë i Shqipërisë në BE do të jetë më i afërt dhe më i sigurtë.

Ju faleminderit!



10 VITE KMD

q) Raste të trajtuara në total në 10 vite 1372 (ku përfshihen edhe çështjet e nisura kryesisht), ndër këto:

52 % e ankesave fizikisht nëpërmjet Zyrës qendrore në Tiranë.
5 % Ankesa të ardhura nga Zyrat Rajonale të hapura në vitin 2018.
36% e ankesave me postë tradicionale dhe elektronike.
7% Raste të nisura kryesisht, me iniciativë nga Zyra e KMD
42% e Ankesave janë gra.
7% e Ankesave janë depozituar nga Organizata të Shoqërisë Civile dhe kryesisht në raste me interes të gjërë jo tëjashtë individual.
4% e Ankesave, subjektet që kanë pretenduar diskriminim kanë qenë të rinjtë.

q) Çështjet sipas shkaqeve

Neni 1 i Ligjit Nr.10221 datë 04/02/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" parashikon,

"zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtetëzarinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionë gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër".

Nisur nga shkaqet e diskriminimit në % janë treguar grupet shoqërore që kanë pretenduar më shumë çënime të të drejtave nga sjelljet diskriminuese. Më rreth 30 % të rasteve janë pretenduar më shumë së një shkak diskriminimi (diskriminim i shumfishtë).

28% e rasteve të diskriminimit të pretenduar kanë pasur si shkak Racën.

12% Bindjet politike

10% Gjendja ekonomike

8% Aftësi e kufizuar

7% Gjinia

5% Gjendja shëndetësore

u) Fushat e diskriminimit

Ligji Nr.10221 datë 04/02/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" parashikon fusha të gjera shërbimesh ku qytetarët mund të diskriminohen si:

"a) mundësi për të hyrë në një vend ku publiku lejohet të hyjë ose për të përdorur një vend, i cili lejohet për t'u përdorur nga publiku; b) mundësi për të marrë ose


për të përfituar nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin; c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të tëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun; ç) mundësi për të përdorur ose për të hyrë në një institucion arsimor; d) sistemimin në një vend ku ofrohet strehim; dh) shitjen ose dhënie me qira të banesave dhe të mjediseve të tjera; e) shërbimet e bankës dhe mundësi për të siguruar grante, huadhënie, depozita bankare ose financim; f) lehtësi për angëzim, çlodhje e freskimi; g) lehtësi për transport ose udhëtim; g) shërbimet e profesioneve të lira".

Por, në veçanti Ligji i kushton një vëmendje të veçantë fushës së punësimit dhe arsimit.

- 9% e çështjeve kanë qenë në fushën e Arsimit
- 33% Punësimi
- 58% Shërbime të tjera

► Në 12% të rasteve pretendimet e diskriminimit për ofrimin e shërbimeve janë adresuar kundrejt subjekteve private.

iv) Ankesat sipas bashkive duke pasur parasysh vendbanimin e ankuesve:



v) Vendimmarrja e Institucionit sipas shkaqeve

Zyra e KMD në 10 vite 826 Vendime themeli ku është vendosur Diskriminim ose Mos Diskriminim. 40% ndër vendimet e themelit kanë konstatuar diskriminim. Ndër këto:

- 35% e vendimeve kanë konstatuar diskriminim me shkak racën.
- 14% Bindjet politike
- 9% Aftësinë e kufizuar
- 6% Gjendja ekonomike
- 5% Gjendja shëndetësore

► 5% e vendimeve ka patur si viktimë diskriminimi tëmijet

- ▶ 5% e çështjeve janë mbyllur me ndërmjetësim ose pa mbaruar procedurat helimore
- ▶ 3.5% vendime gjobe.

Për herë të parë në vitin 2019, Vendimet e diskriminimit kanë kaluar në numër vendimet e mosdiskriminimit dhe po këtë vit Vendimet e diskriminimit kanë qenë në numrin më të lartë në krahasim me vitet e tjera.


Vendime themeli në lidhje me përdorimin e gjuhës së urrejtjes janë 24, nga këto 40 % janë dhënë vendime diskriminimi.

- ▶ Rreth 50 Rekomandime janë dhënë për përmirësim aktesh ligjore dhe nënligjore.
- ▶ Rreth 50 Marrëveshje Bashkëpunimi janë nënshkruar me institucione publike dhe OSHC.

vi) Çështjet në Gjykata

Vendimet e KMD mund të ankësohen në Gjykatën Administrative, si dhe Komisioneri thirret nga Gjykatat Civile për çdo çështje që janë duke gjykuar në lidhje me diskriminimin.

KMD ka marrë pjesë në 309 procese gjyqësore. Nr i çështjeve gjyqësore ka ardhur progresivisht në rritje ndër vite:



Statusi i KMD-së në proceset gjyqësore:

- 152 procese si palë e paditur
- 121 procese si palë e tretë
- 36 kërkesa për Urdhër Ekzekutimi

vii) Vendimarrja e Gjykatave

Gjatë viteve 2012-2019, Gjykatat kompetente kanë dalë me 167 Vendime:

- 103 vendime për çështje ku KMD ka qenë palë e paditur në Gjykatën Administrative
- 40 vendime ku KMD ka qenë palë e tretë në Gjykatën Civile
- 24 vendime për Urdhër Ekzekutimi.
- ▶ Rreth 70% e vendimeve të gjykatave administrative kanë mbajtur vendimet e Komisionerit.
- ▶ Rreth 35% e vendimeve të gjykatave civile kanë njohur diskriminim dhe dëmshpërblim.
- ▶ 10 % të vendimeve janë marrë nga Gjykatat e Apelit.



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Kreu i KMD:

Z. Robert Gajda

Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është institucion i pavarur i Republikës së Shqipërisë. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Ai mbështetet nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), e cila ka personelin dhe pajisjet e nevojshme për të mbështetur Komisionerin në përmbushjen e detyrave të ngarkuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010.

Për informacione të mëtejshme mbi aktivitetet:
www.kmd.al

Zyra qendrore e KMD

Rr: Rruga e Durrësit (Ish Ministria e Mjedisit)
Tirana, Albania
Zip Code: 1001
E-mail: info@kmd.al
Tel:
Komisioneri: + 355 4 243 1077
Ankesa: + 355 4 243 1078

Zyra rajonale:

Shkodër: Ish-Konvikti Safet Spahiu, Rruga: Edith Durham
Zip Code: 4001
Tel: + 355 4 243 1078

Korçë: Pranë Bashkise Korçë Rr:28 Nentori Nr.1
Zip Code: 7001
Tel: + 355 4 243 1078

Fier: Pranë pranë Qendrës së Integruar "ADISA". Lagjia 11 janari.,
Zip Code:
Tel: + 355 4 243 1078